



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 70, datë 04.12.2025



PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË ALOKUAR NGA BUXHETI I SHTETIT NË ZBATIM TË VKM NR. 483, DATË 02.09.2025, “PËR DHËNIE SHPËRBLIMI PERSONELIT TË ANGAZHUAR NË OPERACIONET PËR SHUARJEN E ZJARREVE GJATË VITIT 2025”

Në zbatim të ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. Nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, i ndryshuar, Vendimit nr.483, datë 02.09.2025 të Këshillit të Ministrave “Për dhënie shpërblimi personelit të angazhuar në operacionet për shuarjen e zjarreve gjatë vitit 2025”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 5,208,000 (pesëmilion e dyqind e tetë mijë) lekë të alokuar nga buxheti i shtetit në formën e transfertës sektoriale në zbatim të VKM-së nr. 483, datë 02.09.2025, “Për dhënie shpërblimi personelit të angazhuar në operacionet për shuarjen e zjarreve gjatë vitit 2025”, sipas tabelës së mëposhtme:

Kodi institucionit	Emri institucionit	Gr.	Kapitulli	Programi	Kodi projektit	Llogaria ekonomike	Vlera (në lekë)
2107001	Bashkia Durrës (MZSH)	00	01	03280	90001AA	600	5,208,000

2. Ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e MZSH për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHLLIT BASHKIAK Durrës


Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 05.12.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës



Nr. 835/prot.
2

Durrës, më 11.12.2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.70 datë 04.12.2025 ,” Për miratimin e përdorimit të fondit të alokuar nga buxheti i shtetit në zbatim të VKM-së nr.483, datë 02.09.2025,”Për dhënie shpërblimi personelit të angazhuar në operationet për shuarjen e zjarreve gjatë vitit 2025”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI
EMILJAN JANI**

